



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 148, Datë 24.04.2023

MBI

**HEQJEN E LICENCËS PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË “TERNA ENERGY TRADING” SH.P.K.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, pika 1, gërma “ç” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 5, gërma “ç” dhe nenit 9, gërma “c” të Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.04.2017; nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe pikës 5.1, gërma “ç” të “Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike” miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.04.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 961/1 prot., datë 18.04.2023, të përgatitur nga Grupi i Punës “Mbi heqjen e licencës Nr. 444, Seria T19, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “TERNA ENERGY TRADING” sh.p.k.”

**Konstatohet se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 49, datë 20.02.2023, vendosi të fillojë procedurën për heqjen e licencës Nr. 446, Seria T19, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “TERNA ENERGY TRADING” sh.p.k. me vendimin e bordit të ERE-s nr. 105, datë 20.06.2019.
- Ky vendim u mor për arsye se shoqëria nuk kishte shlyer në afat ndaj ERE-s pagesën rregullatore të vitit 2022 për licencën për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, e po ashtu nuk kishte depozituar në ERE asnjë dokument apo argument në lidhje me mos zbatimin e këtij detyrimi.
- Me shkresën nr. 961 prot., datë 27.02.2022, ERE i ka njoftuar shoqërisë vendimmarrjen si më sipër, duke i bërë me dije se gëzon të drejtën për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi. Kjo shkresë është kthyer nga shërbimi postar.

Adresa e e-mailit që rezulton nga ekstrakti historik i regjistrit tregtar të shoqërisë i përket një personi që nuk punon më në shoqëri, konstatuar nga komunikimi me herët me këtë person nëpërmjet postës elektronike, ndërsa numri i telefonit që gjendet në këtë ekstrakt nuk është funksional.

- Vendimi i bordit të ERE-s nr. 49, datë 20.02.2023 është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 39, datë 10.03.2023.
- Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në njoftimin e vendimit të sipërcituar (30 ditë nga marrja dijeni nga Fletorja Zyrtare) rezultoi se subjekti nuk mori asnjë masë për shlyerjen e debisë apo për të dhënë shpjegime në lidhje me këtë fakt, si dhe nuk ka bërë përpjekje për të shmangur shkakun ligjor që çoi ERE-n në fillimin e procedurës për marrjen e masës administrative për heqjen e licencës.
- Në nenin 42, pika 1, gërma “ç” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenin 5, gërma “ç” të “Rregullores për procedurat e heqjes së licensave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.04.2017, si dhe pikën 5.1, gërma “ç” të Kushteve të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, parashikohet se: *ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE.*
- Në nenin 9, gërma “c” të “Rregullores për procedurat e heqjes së licensave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.04.2017, parashikohet se:  
*Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas nenit 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë për:*  
*c) të hequr licencën subjekt i kushteve të përcaktuara në pikat "a", "b", "c", "ç" dhe / ose "d" të nenit 5 të kësaj rregulloreje në bazë të propozimit të paraqitur në raport, në përputhje me nenin 8 të kësaj rregulloreje.*
- Me heqjen e licencës Nr. 446, Seria T19, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 105, datë 20.06.2019 shoqëria “TERNA ENERGY TRADING” sh.p.k. nuk mban më statusin e të licencuarit nga ERE dhe nuk mund të ushtrojë më veprimtarinë për të cilën ishte licencuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të heqë licencën Nr. 446, Seria T19, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “TERNA ENERGY TRADING” sh.p.k. me vendimin e bordit të ERE-s nr. 105, datë 20.06.2019.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar bëhet e pavlefshme.
3. Grupi i punës, të njoftojë shoqërinë “TERNA ENERGY TRADING” sh.p.k., shoqërinë ALPEX sh.a., dhe operatorët e rrjetit (Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a. dhe Furnizuesin e Tregut të Lirë sh.a.), për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**